



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.494/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Limak Kosova International Airport JSC”, me seli ne Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit me nr.332/2020 i datës 08.06.2020 dhe nr. 01-14-66/2 të datës 10.03.2020, i të paditurës Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë publik më datë 14.03.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, L.F. ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, ndërsa më datë 25.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Limak Kosova International Airport JSC”, me seli ne Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me nr.332/2020 të datës 08.06.2020 dhe Vendimit nr. 01-14-66/2 të datës 10.03.2020, të paditurës Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Trupi Ekzekutiv, me propozim që gjykata të detyroj Ministrinë e Punës dhe e Mirëqenies Sociale-Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, që të paguaj të gjitha shpenzimet procedurale, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, **si e pa bazuar**.

- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 20.10.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative paditësi “Limak Kosova International Airport JSC”, me seli në Prishtinë, ka parashtruar kundër të paditurit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, me kërkesëpadi që gjykata të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit dhe të anulohen vendimet nr.332/2020 i datës 08.06.2020 dhe nr. 01-14-66/2 të datës 10.03.2020, të nxjerra nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, të detyrohet Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale-Trupi Ekzekutiv i Inspektorëve të Punës, që të paguaj të gjitha shpenzimet procedurale, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Lënda është evidentuar me nr. A.nr. 1734/2020.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 494/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik më datë 14.03.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit L.F., zyrtare ligjore tek paditësi sipas autorizimit të datës 09.10.2020, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur sipas autorizimit, pasi gjykata konstatoj se e paditura ftesën për seancë e ka pranuar më datë 21.02.2024, ftesës nuk i është përgjigjur, mungesën nuk e ka arsyetuar, andaj konform nenit 42 të LKA-së, seanca u mbajt në mungesë të palës të ftuar në mënyrë të rregullt.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, e paditura pas inspektimit që kishte bërë në hapësirat e aeroportit më datë 10.03.2020 ka nxjerr vendim Nr. 01-14-66/2 me të cilin kishte shqiptuar masë ndëshkimore/gjobë ndaj paditëses, në shumë prej 10,000.00 euro, edhe përkundër që e paditura gjatë gjithë inspektimit kishte pasur bashkëpunim me zyrtarët e paditëses, të cilët ju ishin përgjigjur çdo kërkesë nga ana e të paditurës, në mënyrë korrekte madje, paditësja në lidhje më këtë rast të inspektimit

ishite deklaruar për të dhënat e kërkuara dhe kjo vërtetohet edhe nga vetë vendimet e kontestuara dhe në asnjë moment nuk e ka kufizuar qasjen për inspektim, andaj edhe gjoba është në kundërshtim të plotë me nenin 12 të UA, nr.07/2021, ku përcaktohet se “Nëse punëdhënësi, nuk deklarohet për të dhënat e kërkuara, nuk e prezanton dokumentacionin e deklaruar apo nuk lejon qasje për inspektim, i shqiptohet gjoba në maksimumin e lartësisë së gjobës konkrete të përcaktuar me këtë udhëzim administrativ”. Andaj nga kjo shihet qartë se paditësja nuk ia ka kufizuar në asnjë moment qasjen gjatë gjithë inspektimit të ushtruar nga e paditura, mirëpo edhe përkundër kësaj e paditura nxjerr një vendim pa asnjë bazë ligjore dhe të njëanshëm. Për t’i evituar këto shkelje paditësja ka ushtruar ankesë mirëpo edhe nga arsyetimi i vendimit të shkallës së dytë, është një vendim i njëanshëm, përmban paqartësi pasi që e paditura me qëllim i ka anashkaluar faktet vendimtare duke krijuar një gjendje të paqenë në realitet në mënyrë që t’i përshtatet kinse dispozitave për të lëshuar një masë ndëshkimore e që në realitet përveç që nuk kemi të bëjmë me një gjendje të tillë, e paditura me qëllim i referohet bazës së gabuar prandaj, paditësja konsideron se ky vendim nuk i plotëson as kushtet e parapara me nenin 48 të LPA nr.05/L-031 si dhe është në kundërshtim të plotë me nenin 86 të ligjit në fjalë.

5. Ka deklaruar se, përveç tjerash, ajo çka është esenciale është se e paditura ka dështuar të merr një vendim të përcaktuar me afatin të cilin e parasheh ligji për inspektoratin e punës nr.2002/9 i ndryshuar me ligjin nr.03/L-017, nenin 6 par. 2 në të cilën qartazi është paraparë afati prej 60 ditëve për marrjen e vendimit sipas ankesës, pra në këtë rast e paditura nuk ka dhënë asnjë vendim për shtyrjen e këtij afati ashtu siç parashihet edhe me nenin 98 të LPPA-së, nr.05/L-031. Pra, në këtë rast do të duhej të zbatohet neni 100 i të njëjtit ligj pasi që kemi të bëjmë me aktin administrativ të miratuar në heshtje, pasi që sipas këtij neni konsiderohet se ankesa e paditëses adresuar për shkallën e dytë, është e pranuar në tërësi dhe se është miratuar në heshtje. Pra vendimi i shkallës së parë do të duhej të anulohet.
6. Për më tepër ka deklaruar se, shkalla e dytë e IP-së, ka pranuar ankesën me datë 20.03.2020 dhe ka marrë një vendim me datë 08.06.2020, nga e cila shihet qartë që ka tejkaluar afatin prej 60 ditësh, për më tepër neni 52 i LPA-së ka sqaruar qartazi paligjshmërinë e aktit administrativ, pra vendimi është i paligjshëm i cili duhet të

anulohet. E paditura në vendimet e tyre, gabimisht konstaton se kinse paditësi nuk i ka prezantuar dokumentet e kërkuara, respektivisht se paditësi nuk ka prezantuar dëshmi në lidhje me performancën për vitin 2019 për punonjësit të cilëve nuk iu është vazhduar kontrata e punës, e që ky konstatim nuk është i drejtë dhe nuk pasqyron realitetin sepse vlerësimi i performancës për vitet paraprake nuk mund të jetë subjektiv i njoftimit për të mos ripërtërirë të kontratës së punës, pasi neni 67 i Ligjit të Punës nuk e parasheh një gjë të tillë, dhe e paditura ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të saktë të gjendjes faktike duke e pas parasysh se ka lëshuar masë ndëshkimore për të cilën gjë e paditura ka qenë e njoftuar se vlerësimi i performancës është proces i pa përfunduar dhe mbi të gjitha paditësi në këto raste ka vepruar në bazë të nenit 67 dhe se mos vazhdimi i kontratës së punës nuk ka të bëjë me vlerësim të performancës pasi që nga shkresat e lëndës qartazi shihet se kem të bëjmë me skadim të kontratës sipas fuqisë ligjore. Andaj paditësja këto njoftime i ka dorëzuar në përputhje me dispozitat ligjore 30 ditë para përfundimit të kontratave. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit dhe anulohen vendimet nr.332/2020 i datës 08.06.2020 dhe nr. 01-14-66/2 të datës 10.03.2020, i nxjerr nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, të detyrohet Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale-Trupi Ekzekutiv i Inspektorëve të Punës, që të paguaj të gjitha shpenzimet procedurale, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

Kundërshtimet e të paditurës

7. Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigje në padi të datës 06.02.2024 ka deklaruar se Organi i shkallës së dytë, pas administrimit të provave në bazë të dokumentacionit të prezantuar dhe pretendimeve ankimore ka konstatuar se, Inspektorët e lëndës si organ të shkallës së parë kanë konstatuar se punëdhënësi nuk ju ka ofruar dokumentacionin e kërkuar për shqyrtim, lidhur me pretendimet ankimore të palëve ankuese në kontestin e ngritur për mos vazhdim të kontratave të punës për 51 punonjës të “Limak Kosova International Airport ISO”. Pas shqyrtimit të ankesës është konstatuar se punëdhënësi në përshkrimin e situatës në fazën inspektuese ka kontestuar objektin e inspektimit marrëveshjen në mes punëdhënësit dhe sindikatës së punëtorëve, pastaj nga inspektorët është kërkuar që marrëveshjen ta kërkojnë tek Sindikata, pra në rastin konkret konstatohet se punëdhënësi ka refuzuar të prezantoj marrëveshjen

punëdhënës-sindikate me këtë veprim me të drejtë është konstatuar se zyrtarët të cilët e kanë përfaqësuar punëdhënësin e subjektit juridik me veprimet e tyre më datë 09.03.2020, kanë cenuar autorizimet zyrtare të inspektorëve të punës dhe obligimet ligjore duke mos bashkëpunuar në ofrimin e dokumentacionit të kërkuar për prezantim i cili ka qenë i nevojshëm në inspektimin e bërë në subjektin juridik “Limak Kosova International Airport JSC”. Gjithashtu në ankesë, punëdhënësi ka kundërshtuar konstatimin e inspektorëve të punës lidhur me mos prezantimin e vlerësimeve të performancës punonjësve, duke njoftuar inspektorët se procesi i performancës ende nuk ka përfunduar. Prandaj me vendim nr. 01-14-66/2 kundërshtimi hedhet poshtë si i pa bazuar, sepse Inspektorët me të drejtë kanë konstatuar dhe argumentuar mos bashkëpunimin e punëdhënësit lidhur me mos prezantimin e dokumentacionit në fjalë. I propozon gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Limak Kosova International Airport JSC”, me seli ne Prishtinë dhe të mbetet në fuqi Vendimi i IP.nr. 332/2020 i datës 08.06.2020.

Provat e administruara

8. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Aktvendimi me nr.01-14-66/2 me datë 10.03.2020 për shqiptimin e masës ndëshkuese, Vendimi me nr. IP 332/20 me datë 08.06.2020 nga organi i shkallës së dytë me të cilën refuzohet ankesa e paditësit dhe vërtetohet vendimi i organit të shkallës së parë, Ankesa e parashtruar nga paditësi kundër vendimit të organit të shkallës së parë me datë 18.03.2020, Ankesë më datë 16.04.2020, Raport zyrtar i IP me nr.01-14-66/1 me datë 04.03.2020, Raport zyrtar i IP me nr.01-14-66/2 me datë 09.03.2020, Propozim për përmbarrim nga e paditura me datë 03.11.2020.
9. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklarimet

e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

10. Nga Aktvendimi me nr.01-14-66/2 me datë 10.03.2020 për shqiptimin e masës ndëshkuese, Inspektorët e punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kanë marr vendim për shqiptimin e masës ndëshkimore andaj punëdhënësit Limak Kosova International Airport J.S.C. SH.A., duke konstatuar se është përgjegjës për mos bashkëpunim, andaj në mbështetje të nenit 12 të UA 07/2012, për përcaktimin e gjobave dhe shumave konkrete për shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës i shqiptohet gjoba në lartësi prej 10,000.00 euro, me arsyetim se me rastin e marrjes se dokumentacionit të inspektimit më datë 09.03.2020, përfaqësuesit e punëdhënësit nuk kanë ofruar dokumentet e kërkuara me arsyetimin se nuk e posedojnë marrëveshjen me sindikatën, ndërsa raportet e performancës për vitin 2019 nuk janë bërë punonjësve për të cilëve nuk ju ka vazhduar marrëdhënia e punës. Më datë 10.03.2020 nga Inspektorët është bërë inspektim në Shoqatën Sindikale të pavarur të punëdhënësit dhe tek të njëjtit janë marrë në shqyrtim marrëveshja e 23 Gushtit 2019 dhe raportet e performancës për disa të punësuar e të cilët punëdhënësi kishte deklaruar se nuk i ka kryer e realisht i ka fshehur me rastin e inspektimit. Andaj fshehja e marrëveshjes së lidhur mes sindikatës dhe punëdhënësit si dhe fshehja e raporteve të performancës për punonjësit për vitin 2019 nga ana e inspektorëve konsiderohet mos bashkëpunim.

11. Me datë 18.03.2020, paditësi “Limak Kosova International Airport JSC, ka parashtruar ankesë kundër vendimit të organit të shkallës së parë për masë ndëshkuese të shqiptuar nga Inspektoratit të Punës me Nr. 01-14-66/2 të datës 10.03.2020.

12. Me Vendimi me nr. IP 332/20 me datë 08.06.2020 organi i shkallës së dytë refuzon ankesën e paditësit “Limak Kosova International Airport JSC”, e ushtruar kundër vendimit Nr. 01-14-66/2, të organit të shkallës së parë të Inspektoratit të punës, si të pabazuar me arsyetim se pas shqyrtimit të ankesës, është konstatuar se punëdhënësi nuk ka bashkëpunuar me inspektorët ka refuzuar të prezantoj marrëveshjen punëdhënëse-sindikatë me këtë veprim me të drejtë është konstatuar se zyrtarët të cilët e kanë përfaqësuar punëdhënësin e subjektit juridik me veprimet e tyre më datë

09.03.2020, kanë cënuar autorizimet zyrtare të inspektorëve të punës dhe obligimet ligjore duke mos bashkëpunuar në ofrimin e dokumentacionit të kërkuar për prezantim i cili ka qenë i nevojshëm në inspektimin e bërë në subjektin juridik “Limak Kosova International Airport JSC”. Gjithashtu në ankesë, punëdhënësi ka kundërshtuar konstatimin e inspektorëve të punës lidhur me mos prezantimin e vlerësimeve të performancës punonjësve të cilët kanë qenë objekt trajtimi, me arsyetim se procesi i performancës ende nuk ka përfunduar, ky kundërshtim është hedhur si i pa bazuar, sepse në arsyetimin e vendimit nr. 01-14-66/2 inspektorët kanë konstatuar se vlerësimet e performancës për disa punonjës janë prezantuar nga Shoqata sindikale, për të cilët punëdhënësi nuk e ka prezentuar me arsyetim se nuk janë bërë ende, prandaj është vlerësuar se Inspektorët me të drejtë kanë konstatuar dhe argumentuar mos bashkëpunimin e punëdhënësit lidhur me mos prezantimin e dokumentacionit në fjalë.

13. Inspektorët e punës më datë 04.03.2020 kanë kryer kontrollë inspektuese lidhur me rastin e mos vazhdimit të kontratave për një numër të punëtorëve 28, punëtorë të cilët më datë 03.03.2000 janë njoftuar për mos vazhdim të kontratës. Në Raport zyrtar i IP me nr.01-14-66/1 me datë 04.03.2020, është bërë edhe inspektimi i dokumentacionit të 23 punëtorëve të cilët më datë 31 Janar iu është skaduar kontrata e punës. Me rastin e inspektimit të punëdhënësi janë marrë në shqyrtim, performanca e vitit 2017 dhe 2018 Kontratat e punës dhe pushimet vjetore, ndërsa punëdhësi është obliguar të prezantoj dokumentacionin e 23 punonjësve të larguar më 31 Janar duke përfshirë kontrata, njoftimet për mosvazhdim, vendimet, dëshmitë e shfrytëzimit të pushimeve, vendimet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, të prezantohen më datë 09.03.2020.

14. Sipas Raportit zyrtar me nr.01-14-66/2 me datë 09.03.2020, nga inspektorët e punës është konstatuar se lidhur me kompletimin e dokumentacionit për 28 punëtorë të cilët më datë 03.03.2020 janë njoftuar për mos vazhdim të kontratave të punës, u prezantuan raportet e pagesave të anëtarëve në llogari, u prezantuan vendimet për punëtorëve të cilëve u janë shqiptuar masat ndëshkimore për vitin 2018, 2019, ndërsa për punëtorët B.Sh. dhe L.L. ndaj të cilëve ende nuk është marrë ndonjë vendim, edhe pse procedura është zhvilluar ndaj tyre, janë prezantuan vendimet e pushimeve vjetore për vitin 2019, u prezantua kontrata e punës për 23 punëtorë, nuk janë

prezantuar performanca për vitin 2018/2019, janë prezantua vendimet-njoftimet për mos vazhdim të kontratave së punës për 21 punëtorë ndërsa për 2 punëtorë mungojnë, nga 21 vendime 6 prej tyre janë pa nënshkrim, punëdhënësi nuk ka prezantuar procesverbalin e mbledhjes së bordit, nuk u prezantuan analizat financiare, teknike, organizative, nuk u prezantuan vendimet e bordit, nuk u prezantua marrëveshja e punëdhënësit me sindikatën e aeroportit për muajin gusht 2019 por ishte kërkesë e drejtorit të burimeve njerëzore që marrëveshja të prezantohet nga ana e sindikatës sipas kërkesës së Kryeshefit ekzekutiv-drejtorit gjeneral. Punëdhënësi kishte deklaruar se vendimet dokumentet e bordit të drejtorëve nuk u prezantuan sepse pasi që mos vazhdimi i kontratave nuk hyjnë në dispozitat për largim kolektiv.

15. Nga Propozim për përmbarim nga e paditura me datë 03.11.2020, është lejuar propozimi për përmbarim nga përmbaruesi privat për kreditorin Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës kundër debitorit “Limak Kosova International Airport JSC”, me seli ne Prishtinë, vlera e borxhit 10,000.00 euro.

Baza Ligjore

16. Ligji Nr.03/L-212 i Punës, neni 94 përcakton se *“Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe mbrojtjen në punë, e bën Inspektorati i Punës në bazë të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe Ligji Nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës.”*
17. Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjit Nr. 03/L-017, Neni 2, ku përcaktohen funksionet e Inspektoratit të punës, përkatësisht ku përcaktohen funksionet e Inspektoratit të punës, që: a) *Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë b) Do t’iu siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënëseve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore. c) Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm. d) Do t’iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënëseve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t’i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që*

nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese e) Do t'iu jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje, dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9, i cili në nenin 3 përcaktuar: “Teksti të pika „a” e nenit 2 „, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet më tekstin „Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë.

18. Udhëzim Administrativ Nr.07/2012 për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për Shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës, neni 6 përcakton se “Gjobat e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ, do të shqiptohen nga inspektori i punës, për personat fizik dhe juridik të cilët nuk i kanë evituar parregullsitë e konstatuara me raport zyrtar në afatin e dhënë me vërejtje me shkrim”, neni 12 përcakton se “Nëse punëdhënësi, nuk deklarohet për të dhënat e kërkuara, nuk e prezanton dokumentacionin e deklaruar apo nuk lejon qasje për inspektim, i shqiptohet gjoba në maksimumin e lartësisë së gjobës konkrete të përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ”.

Vlerësimi i gjykatës

19. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi dhe kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 41 par.1 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
20. Nga provat e administruara, gjykata konstatoi se sipas vendimit Aktvendimi me nr.01-14-66/2 me datë 10.03.2020 për shqiptimin e masës ndëshkuese, Inspektorët e punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kanë marr vendim për shqiptimin e masës ndëshkimore andaj punëdhënësit Limak Kosova International Airport J.S.C. SH.A., duke konstatuar se është përgjegjës për mos bashkëpunim, andaj në mbështetje të nenit 12 të UA 07/2012, prandaj të njëjtit për përcaktimin e gjobave dhe shumave

konkrete për shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës i shqiptohet gjoba në lartësi prej 10,000.00 euro, ndërsa me vendimin e kundërshtuar me nr. IP 332/20 me datë 08.06.2020 nga organi i shkallës së dytë është refuzuar si e pa bazuar ankesa e palës në procedurë “Limak Kosova International Airport JSC”, e ushtruar kundër vendimit Nr. 01-14-66/2, të organit të shkallës së parë të Inspektoratit të punës, me arsyetim se pas shqyrtimit të ankesës, është konstatuar se punëdhënësi në përshkrimin e situatës në fazën inspektuese fillimisht ka kontestuar objektin e inspektimit lidhur me marrëveshjen në mes punëdhënësit dhe sindikatës së punëtorëve, inspektorët janë udhëzuar që marrëveshjen ta kërkojnë tek Sindikata, me cka është konstatuar se ka refuzuar të prezantoj marrëveshjen punëdhënëse-sindikatë. Me këtët janë cënuar autorizimet zyrtare të inspektorëve të punës dhe obligimet ligjore duke mos bashkëpunuar në ofrimin e dokumentacionit të kërkuar për prezantim i cili ka qenë i nevojshëm në inspektimin e bërë në subjektin juridik “Limak Kosova International Airport JSC”. Gjithashtu në kërkesën e inspektorëve të punës për prezantimin e vlerësimeve të performancën punonjësve të cilët kanë qenë objekt trajtimi, punëdhënësi/paditësi i ka njoftuar inspektorët se procesi i performancës ende nuk ka përfunduar, inspektorët të njëjtat vlerësimet e performancës i kanë gjetur nga Shoqata sindikale, e për të cilët punëdhënësi kishte deklaruar se nuk janë bërë ende, andaj nga ky veprim i kërkuar.

21. Fillimisht në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, gjykata vlerësoj bazën ligjore për ta vlerësuar kompetencën e Inspektoratit të Punës për nxjerrjen e vendimit të kontestuar prandaj vlerësoj. Lidhur me vlerësimin e kompetencës së të paditurit Gjykata iu referua Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjit Nr. 03/L-017, Neni 2, ku përcaktohen funksionet e Inspektoratit të punës, që: a) *Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë* b) *Do t’iu siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënëseve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore.* c) *Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm* d) *Do t’iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t’i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese,* e)

Do t'iu jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje, dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9, i cili në nenin 3 përcaktuar: “Teksti të pika „a” e nenit 2 „ kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet më tekstin „Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë.”

22. Gjykata i vlerësoi provat e administruara në përputhje me dhe dispozitat ligjore materiale që rregullojnë këtë çështje dhe vlerëson se vendimi kontestuese i nxjerrë nga e paditura Inspektorati i Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është nxjerrë në përputhje me kompetencave ligjore të cilat i ka Inspektorati i Punës. Sepse, për realizimin e kompetencave ligjore, në përputhje Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9 nenin Neni 2, të cituar ma lartë, inspektorati i punës është i autorizuar konform nenit 5 të njëjtit ligj në qasje të papenguar në çdo vend pune dhe në seli të punëdhënësit në kuadër të kompetencave të inspektimit të tyre pa paralajmërim të bëjë ekzaminimet, inspektimet dhe hulumtimet të cilat konsiderohen të domosdoshme për t'u siguruar se dispozitat e ligjit do të zbatohen, të bëjë kontrollimin e të gjitha librave dhe dokumenteve të cilat duhet t'i mbajë punëdhënësi siç është përcaktuar me ligjin e punës, t'i marrë ekstraktet nga regjistrat dhe dokumentet; të kërkojë nga punëdhënësi dërgimin e shënimeve apo dokumenteve të cilat janë kërkuar, etj.
23. Gjykata vlerëson se në pamundësi të qasjes së lirë Inspektorati i Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale do ta kishte të pamundur realizimin e kompetencave ligjore, për mbikëqyrje të zbatimit e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, për tu siguruar informacion, informata dhe këshilla punëdhënëseve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore. Në relacion më të drejtën e IP në qasje të papenguar për inspektim përcaktohet detyrimi ligjor i secilit punëdhënës që ti siguroj qasje të papenguar në kuadër të kompetencave të inspektimit në çdo vend pune në seli të punëdhënësit.

24. Gjykata vlerëson se përkundër që Inspektorati i Punës nuk ka kompetencë ligjore për vendosje lidhur me të drejtat e të punësuarve nga marrëdhënia e punës, e që sipas nenit 79 të Ligjit të Punës kjo e drejtë i takon vetëm Gjykatës, ku përcaktohet se: *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.”* Inspektorati i Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka të drejtë që në çdo rast ti inspektoj të gjitha dokumentacionet kur pretendohet se të punësuarit i janë shkelur të drejtat e tij në mënyrë që punëdhënëseve dhe punëtorëve tu siguroj këshilla dhe informacion për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore, përfshirë edhe këshillimin e punëtorëve dhe ndihmën për t’ju drejtuar gjykatës kompetente për shqyrtimin e pretendimeve të tij.
25. Në këtë drejtim, Udhëzimi Administrativ Nr.07/2012 për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për Shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës ka saktësuar në nenin 12 se *“Nëse punëdhënësi, nuk deklarohet për të dhënat e kërkuara, nuk e prezanton dokumentacionin e deklaruar apo nuk lejon qasje për inspektim, i shqiptohet gjoba në maksimumin e lartësisë së gjobës konkrete të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ”,* andaj gjykata vlerëson se e paditura drejt ka vlerësuar gjendjen faktike, ngase është bazuar në provat materiale raport zyrtar të IP-së pas konstatimeve të inspektorëve gjatë kohës së inspektimit të subjekti juridik tani paditës kanë marr vendim për shqiptimin e masës ndëshkimore ndaj punëdhënësit Limak Kosova International Airport J.S.C. SH.A., sepse është konstatuar se paditësi është përgjegjës për mos bashkëpunim, në mbështetje të nenit 12 të UA 07/2012, sepse përfaqësuesit e punëdhënësit nuk kanë ofruar dokumentet e kërkuara me arsyetimin se nuk i posedojnë, e të cilat me të drejtë është konstatuar se të njëjta është dashur ti posedojnë sepse raportet e performances të cilat janë gjetur në sindikatë vetë paditësi i ka lëshuar. Prandaj gjoba e shqiptuar dhe shumave konkrete për shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës, duke i shqiptuar në lartësi prej 10,000.00 euro, për shkak të mos prezantimit e dokumentacionit të kërkuar nga e paditura gjatë kohës së inspektimit është në përputhje me Udhëzimin Administrativ 07/2012.

26. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palës paditëse se ka vepruar në bazë të nenit 67 dhe se mos vazhdimi i kontratës së punës nuk ka të bëjë me vlerësim të performancës pasi që nga shkresat e lëndës qartazi shihet se kem të bëjmë me skadim të kontratës sipas fuqisë ligjore dhe se paditësja këto njoftime i ka dorëzuar në përputhje me dispozitat ligjore 30 ditë para përfundimit të kontratave, por gjykata vlerëson nuk është objekt i vlerësimit çështja e ndërprerjes apo vazhdimit të kontratave të punës, por ligjshmëria e vendimit administrativ në shqiptimit e masës ndëshkimore, bazuar në nenin 12 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2012 për Përcaktimin e Gjobjave dhe Shumave Konkrete për Shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës, vetëm sa i përket detyrimit për bashkëpunim të punëdhënësit tani paditësit me inspektoratin e punës.
27. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.494/22, datë 25.03.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.